



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 3038 Prot.

Vlorë, më 03/10/2023

Lënda : *Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit)*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

• Drejtoria e Burimeve Mbështetëse

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj Shpalljen Publike të një akti administrativ – Vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore si vijon :

• Nr.76, me Nr.2673/2 Prot., datë 18/09/2023, i materializuar për subjektin “InMec” sh.p.k, me NIPT L77308202R, me seli në Vlorë (Fshati Mifol, Zona Kadastrale 2689, nr pasurie 135/13-T, Rruga nacionale Vlorë-Fier Km 15).

Bashkëngjitur, gjeni kopje origjinale të aktit të lartcitur - gjithsej 5 (pesë) fletë.

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes së aktit të lartpërmendur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 2673/2 Prot.

Vlorë, më 18/09/2023

VENDIM Nr.76

Sot, më datë 18/09/2023, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit “InMec” sh.p.k, me NIPT L77308202R, me seli në Vlorë (Fshati Mifol, Zona Kadastrale 2689, nr pasurie 135/13-T, Rruga nacionale Vlorë-Fier Km 15), si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0007853, nr.2673 Prot., datë 01/09/2023, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

K O N S T A T O V A S E :

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.441/10 Prot., datë 19/07/2023, protokolluar me Tonën me nr.144/10, datë 20/07/2023, me lëndë “*Dërgohet Raporti Përfundimtar për auditimin e kryer në Doganën Vlorë*”.

Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, nga Dega e Doganës Vlorë u hartua “Plani i Punës” me nr.144/11 Prot., datë 04/08/2023, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Rezulton se dega e doganës Vlorë ka proceduar me shkresën e saj nr.147 Prot., datë 12/01/2023, me lëndë “Program kontrolli”, tematika e të cilit ka qenë “Verifikimi i gjendjes së mallit në magazinën e subjektit “InMec” sh.p.k. Nga kontrolli i ushruar grupi i kontrollit ka mbajtur aktin me numër serial 0019034, me nr.147/2 Prot., datë 13.01.2023, me lëndë “Proces verbal kontrolli fizik / Verifikimi”, në të cilin janë pasqyruar rezultatet e kontrollit.

Nga kontrolli dhe verifikimi i kryer, rezulton se subjekti “InMec” sh.p.k, me NIPT L77308202R, me seli në Vlorë, ka përfituar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave autorizimin e regjimit të përpunimit aktiv nr.6439/1 prot., datë 03.04.2020, për prodhimin e konstruksione, pjesë strukturash mobiljesh, llamarina të prera e salduara në forma, radiator të montuar në konstruksione metalike, pajisje mekanike dore prej metali në fusha të ndryshme, pompa motuar mbi konstruksione metalike, impiante vaditje, agregat për miniera.

Nga verifikimet e kryera nga ana e autoriteteve doganore, ka rezultuar se në fund të periudhës të regjimit të përpunimit aktiv, bilanci material sipas sistemit asycuda / data base kombëtar, paraqitet si vijon : *Tabela. Nr. 1*

Nr	Emertimi	Procedura	Monedha	P. Neto kg	Vlera Fatur	Tax Dog
a	Import 5	5100	Euro	81,291	1,723,453	498,219
b	Import 5	5100	Usd	160	17,970	0
c	Export 3	3151	Euro	87,561	1,610,909	0
d	Diferencat (a+b-c)			-6,110	94,574	498,219

Referuar tabelës së mësipërme – konstatohet se autorizimi nuk i rezulton i mbyllur në të gjitha elementet e bilancit material, për sasinë kg, vlerë dhe taksën doganore.

Në lidhje me bilancin e vlerës nuk mund të konkludohet se kemi veprime në monedha të ndryshme.

Për të konkluduar mbi bilancin në vlerë veprimet duhet të paraqiten në një monedh të vetme.

Për të paraqitur vlerën e bilancit të autorizimit (Tabela nr. 1) në një monedhë të vetme (Euro), importet në monedhën usd u konvertuan në monedhën euro, me kursin e këmbimit të datës të veprimit.

Analiza e importeve në monedhen usd janë ndarë në bazë të procedurës të zgjeruar, konkretisht;

♦ Të dhënat e deklaratave imp. 5, proçeduuë 5100 me monedh USD jane si më poshtë :

Tabela nr. 2.

Autorizimi 20200403/6439/1								Tar Pre Ext					
								5100					
Datë	DA V-i	Tip	NK 8	Pershkrimi	Mon.	Origj.	Tar Prf	P. Net	Vl. USD	Kurs. US	Kurs Eur	Vl. Euro	
15/04/2020	30336	IM	5	84139100	PJES E PC	USD	US	(blank)	160	17,970	118.75	130.66	16,331.99
Grand Total									17,970.0			16,331.99	

Referuar tabelës të mësipërme (Tabela nr. 2), vlera e praktikave doganore të Imp. 5 në monedhën USD të konvertuar në monedhën Euro do të ishte:

Për mallrat e Imp. 5 procedura 5100 do të ishte 16,331.99 Euro

Të dhënat e tabelës nr. 1 të azhornuar me të dhënat e tabelës nr. 2 do të paraqitej si më poshtë :

Tabela nr. 3

Nr	Emertimi	Procedura	Monedh	P. Neto	Vlera e Faturës	Vl. e konv. nw Euro
a	Import 5	5100	Euro	81,291	1,723,453	1,723,453
b	Import 5	5100	USD	160	17,970	16,332
c	Export 3	3151	Euro	87,561	1,610,909	1,610,909
d	Diferencat (a+b-c)			-6,110	130,514	128,876

Në bazë të dhënave të Tabelës nr.3 bilanci material i RPA nuk është i mbyllur, kemi diferencë negative për 6,110 kg, vlerë në shumën 128,876 euro dhe tax doganore në shumën 498,219 lekë.

Për të analizuar diferencën negative në peshë, sasia prej 6,110 kg dhe vlerës në monedhën Euro, u morën në shqyrtim deklaratat e eksportit për të verifikuar nëse në produktin kompensues të rieksporuar ka të trupëzuar mallra me status shqiptar.

Në shqyrtim të të dhënave nga sistemi Asycuda World/Data base kombëtar dhe dokumentave të bashkangjitur deklarave të eksportit u përpilua tabela e eksporteve me të dhënat si mëposhtë.

Tabela nr.4

Txt Rsv 20200403/6439/1						Tar Proc Ext 3151							
Datë	DAV-i	NK-8	Përshkrimi	Mon.	Origj	Sipas të Deklaratës		Sipas Dokumentave Bashkangjitur					
						P. Neto sipas DAV-it	VL. në Euro - Kutia 22	P. Net Matri al në Imp.5	VI. Material. në Euro - Imp.5	P. Neto Mall Shqipt ar	VI. Mall Shqipt ar - Euro	VI. e Punës - Euro	Mbetje
11/06/2020	4723	840999	AKSESOR PER MOTORRA DI	EUR	IT	40	4,600	40	4,400	0	0	200	0
26/06/2020	11235	730840	KONSTRUKIONE STRUKTUR	EUR	AL	6,900	8,000	2,200	1,747	4,700	2,919	5,081	0
24/07/2020	13482	730840	filtra te montuara ne platforme	EUR	AL	60	45,760	60	6,600	0	0	0	0
21/12/2020	24781	730840	PLATFORM PER MINIERAK	EUR	AL	5,000	1,000						
	24782	730840	PLATFORM PER MINIERA	EUR	AL	12,000	40,645	9,124	191,176	7,875	6,337	35,308	624
04/03/2021	5117	841391	mberrhim,rakordim pjes pompe	EUR	AL	1,564	500	1,564	142,654	0	0	500	0
16/03/2021	3117	841370	POMPE E ASEMBLUAR I CO	EUR	ID	138	300	138	2,520	0	0	300	0
10/07/2021	81519	730840	konstruksione metalikvler pune	EUR	AL	11,560	40,120						
	81521	730840	konstruksione metalikvler pune	EUR	AL	8,425	40,120	17,529	105,592	6,515	18,722	101,653	14,788
	81522	730840	konstruksione metalikvler pune	EUR	AL	4,060	40,135						
13/07/2021	9357	841370	POMPA TE ASEMBLUARA M	EUR	AL	815	1,200	815	41,000	0	0	1,200	0
02/09/2021	20896	730840	KONSTRUKSION PER MINI	EUR	AL	18,500	14,950	18,500	557,610	3,845	9,099	5,851	0
10/11/2021	26584	730840	KONSTRUKSION PER MINI	EUR	AL	18,500	9,285	18,500	557,610	1,959	3,434	5,851	0
Grand Total						87,561	246,615	68,470	1,610,909	24,894	40,511	155,944	15,412

Referuar tabelës të mësipërme, Tabela nr. 4, sasia e mallrave shqiptare të trupëzuara në produktin kompensues kryesor është në peshë 24,894 kg.

Nëse peshën e eksporteve do e çvishnim nga pesha e mallrave shqiptare bilanci material për RPA nr. 6439/1 dt., 03.04.2020 do të paraqitet si më poshtë:

Tabela Nr. 5

Nr	Emertimi	Procedura	Monedh	P. Neto	Vlera e Faturës	VI. e konv. nw Euro
a	Import 5	5100	Euro	81,291	1,723,453	1,723,453
b	Import 5	5100	USD	160	17,970	16,332
c	Export 3	3151	Euro	87,561	1,610,909	1,610,909
d	Mallrat Shqiptare			24,894	0	0
e	Diferencat (a+b-c+d)			18,784	130,514	128,876

♦ Për diferencën në sasinë 18,784 kg me vlerë 128,876 euro, grupi i auditimit në mbështetje në nenet 250 “Klasifikimi i shkeljeve” 1. Shkelje doganore janë: - a) kundërvajtjet administrative; të Ligjit Nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës të Shqipërisë”, Nenit 252 “Kundërvajtje të kryera në neglizhencë” pika c, në bazë të nenit 257 pika 1/a dhe pika 2 të Ligjit Nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës të Shqipërisë” rekomandon që autoriteti doganor të verifikojë në terren nëse këto mallrat diferencë të RPA janë gjendje në ambjentet e operatorit.

Nëse ato mallra nuk janë gjendje operatori “InMec” shpk të paguaj detyrimin dhe penalitet dyfishin e detyrimit.

Përlllogaritja e detyrimeve : Sasia 18,784 kg me vlerë 128,876 Euro * 113.21 Kursi = 14,590,052 lekë

Detyrimi = 14,590,052 lekë * 20% = 2,918,010 lekë

Penalitet = 2,918,010 * 2 fishi = 5,836,020 lekë

Totali = 8,754,030 lekë

Detyrimi Doganor	Penalitet	Totali
2,918,010 lekë	5,836,020 lekë 2-fish Neni 257 pika 1/a pika. 2	8,754,030 lekë

Rezulton se Dega e Doganës Vlorë, bazuar në nenin 41 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, ka proceduar me shkresën Nr.1876 Prot., datë 27/06/2023 me lëndë “Njoftim mbi fillimin e procedurës administrative”, me të cilën ka njoftuar subjektin për fillimin e procedurës administrative.

Më tej, nga ana e grupit të punës në përfundim të verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara, është mbajtur procesverbal i shkeljes doganore “kundërvajtje administrative” nr.serial 0007853, me Nr.2673 Prot., datë 01/09/2023, në të cilin është kryer përshkrimi i shkeljes doganore të kryer nga ana e subjektit si vijon : “Subjektit “InMec” sh.p.k i pajisur me autorizimin RPA Nr.6439/1 prot dt. 03.04.2020, nuk ka mbyllur autorizimin dhe rezulton me një diferencë në sasinë 18784 kg, me vlerë 128876 euro. Duke qenë se nga verifikimet e kryera nga Zyra e Mbikqyrjes Doganore mallrat nuk janë gjendje, operatori ekonomik duhet të paguajë detyrimin dhe penalitetin dyfishin e detyrimit. Shkelja është konstatuar nga Drejtoria e Auditimit në DPD”.

Ky proces verbal i është njoftuar subjektit me anë të shërbimit postar me shkresën nr.2673/1 Prot., datë 01/09/2023, me lëndë “Njoftim i proces – verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative”, si dhe me anë të njoftimit publik, konkretisht, me shkresën nr.2679 Prot., datë 01/09/2023 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të proces verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative” drejtuar Bashkisë Vlorë, si dhe me shkresën nr.2680 Prot., datë 01/09/2023 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të proces verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative” drejtuar Prefektit të Qarkut Vlorë, i cili, ka konfirmuar njoftimin publik me shkresën Nr.812/1 Prot., datë 11/09/2023, me lëndë “Mbi shpalljen publike të proces verbaleve të verifikimeve të kundërvajtjes administrative”, administruar në sekretarinë e degës së doganës Vlorë me nr.2680/1 Prot., datë 13/09/2023.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : “Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv” (i ndryshuar),

V E N D O S A :

- Subjekti “InMec” sh.p.k, me NIPT L77308202R, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **2,918,010** (Dymilion e nëntëqind e tetëmbëdhjetëmijë e dhjetë) lekë.
- Subjekti “InMec” sh.p.k, me NIPT L77308202R të penalizohet në në masën e dyfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën **5,836,020** (Pesëmilion e tetëqind e tridhjet e gjashtëmijë e njëzetë) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Zyra e Mbikqyrjes Doganore të procedojë me mundësimin dhe vënien e mallrave përkatës në regjimin doganor të duhur, konform përcaktimeve të legjislacionit doganor për regjimin në fjalë.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “InMec” sh.p.k, me NIPT L77308202R, i lejohej të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), si dhe duke garantuar 100% penaltetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

KRYETAR

Artan Bedinaj

